



**I nderuari kryetar, siç është e ditur Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë është organizatë joqeveritare, apolitike dhe multietnike e krijuar që të mbrojë të drejtat e këtij asociacioni më të madh, në të cilin janë të anëtarësuar rreth 260.000 pensionistë. Çka ka të re në këtë rrafsh?**

Krahas aktiviteteve të tanishme, të cilat në kontinuitet po bëhen tash më shtatë dekada, vazhdimisht kemi edhe aktivitete dhe projekte të reja. Është me rëndësi ajo që vitin e kaluar edhe krahas aktiviteteve të shumta me punë të përgjegjshme kemi realizuar shumë të ardhura, ndërsa të dalat janë ulur. Pres që ky trend të vazhdojë edhe gjatë vitit aktual 2018. Për momentin më aktuale është që të japim mendimin dhe kontributin tonë në lidhje me masat e propozuara për sanimin e SPIM, sepse ne si organizatë jemi të interesuar për pensionistët e tashëm, por edhe për të ata të ardhshëm.

Mendimin tim për këtë problematikë e kam shprehur që nga fundi i vitit të kaluar ku theksova se Qeveria duhet të kujdeset për pensioner me dinjitet për pensionistët e ta-

shëm dhe të ardhshëm. Rritja e kufirit të pleqërisë për dalje në pension, më së shumti do të godasë punëtorët nga degët intensive të punës si dhe të falimentuarit, të cilët kushtet e tanishme për pensionim po i presin me padurim. Zgjidhje për fond të qëndrueshëm pensional duhet të kërkohet në rritjen e numrit të të punësuarve në vendin tonë dhe të pagave të të siguruarve, si dhe në përforsimin e ekonomisë. Me atë do të rritet edhe rrjedhja e mjeteve të nevojshme për Fondin e SPIM.

Në një shtet social siç është Republika e Maqedonisë, gjithashtu duhet të mbahet llogari edhe të mos rritet zbrazëtira mes pensionit më të ulët dhe atij më të lartë.

**Mendimet dhe rekomandimet e juaja janë relevante sepse janë rezultat i njohurive dhe përvojave të grumbulluara gjatë viteve. Gjatë zgjidhjes së këtij problemi me siguri do t'i kenë parasysh institucionet e shtetit që merren me këtë çështje. Kjo ka të bëjë me pensionistët e ardhshëm, ndërsa çka ju preokupon për momentin juve personalisht, por edhe Lidhjen me të drejtat e pensionistëve të tani-**

BISEDË ME DRAGI ARGIROVSKI, KRYETARI I LSHPM

## LIDHJA KUJDESET PËR PENSIONISTËT E TASHËM DHE TË ARDHSHËM

"Krahas kujdesit për standardin e tyre dhe bashkëjetesën, një prej prioriteteve tona në të cilët jemi të fokusuar është sjellja e Ligjit për organizim pensional në Maqedoni", tha Dragi Argirovski, kryetari i LSHPM-së

shëm?

Krahas kujdesit për standardin e tyre dhe bashkëjetesën, një prej prioriteteve tona në të cilët jemi të fokusuar është sjellja e Ligjit për organizim pensional në Maqedoni. Është dhënë iniciativë nga ana jonë që para tre viteve, por asgjë nuk është bërë në drejtim të atij plani, me siguri, sipas meje, është për shkak të ndodhive në vendin tonë. Edhe më tutje ne kërkojmë që shteti të sjellë një ligj të tillë me qëllim që punë të caktuara në lidhje me organizimin pensional në Maqedoni të jenë në nivel që kjo popullatë e meriton. Krahas ligjit, më duhet të përmend edhe problemin e hidhur me barërat, lëvizjen e kufirit për shërim pa participim, transportin e pensionistëve në Shkup dhe qytetet e tyre amë, inkluzionin gjegjësisht përfshirjen e pensionistëve në të gjitha sferat e shoqërisë dhe të tjera.

**Krahas këtyre punëve, të cilat i numëruat, është fakt që Lidhja kujdeset edhe për ruajtjen e shëndetit psikik dhe fizik të anëtarëve të saj. Na tregoni diçka më detajisht në lidhje me aktivitetet në këtë plan.**

Revytë rajonale për këngë, muzikë dhe valle do të mbahen në muajin prill dhe maj, ndërsa ajo republikanë do të mbahet më 5 qershor të këtij viti në Shkup. Tek e nuk

ka këngë, valle dhe tradita tonat e tuajat. Të gjithë jemi të barabartë në atë plan, ndërsa dallimin e trajtojmë si pasurinë tonë kulturore, me çka rrallë kush në Ballkan dhe Evropë do të lavdërohej. Sjellja e personave të gjeneratës së tretë duhet të jetë shembull për gjeneratat më të reja. Sa i përket ruajtjes së shëndetit fizik dhe kondicionit të pjesëtarëve të gjeneratës së tretë edhe këtë vit do të ketë gara sportive rajonale, ndërsa më mirë të plasuarit do të garojnë në Olimpiadën tonë sportive e cila do të mbahet në vjeshtë.

**Për tërë këtë që e thatë, vallë a janë të informuar anëtarët Tuaj?**

Informimit i kushtojmë vëmendje të veçantë. Ajo bëhet përmes lajmëtarëve tanë "Penzioner Plus" i cili botohet me tirazh prej 6000 kopjeve dhe është një prej më të lexuarve për momentin, si dhe përmes "Penzionerski Vidici" shtojcë në gazetën "Nova Makedonija" dhe faqen për pensionistë në gazetën "Koha", gazeta me të cilat kemi bashkëpunim të shkëlqyeshëm shumevjeçar, por edhe në uebfaqen tonë. Si gazetar shumëvjeçar dhe aktivist pensional vërej përhapje të shumë lajmeve të rrejshme dhe tendencioze në rrjetet sociale. Përmes postimeve dhe deklaratave nëpër rrjetet sociale përhapet edhe gjuha e urrejtjes, gjë

që aspak nuk është mirë. Në Kroaci dhe në disa vende të tjera tash më janë sjellë masa dhe ligje për dënim të lajmeve të rrejshme nëpër Internet. Për një gjë të këtillë duhet të mendohet edhe në vendin tonë.

**I nderuari kryetar, në këto kohë të turbullta si gjendet Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë?**

Ndihmë e kemi përvojën dhe mençurinë tonë. Po mundohemi të allafaqohemi me çdo gjë dhe duke i shpjeguar në mënyrë të hollësishtme gjërat për të mbijetuar. Kup-tohet çdoherë mund të bëhet më mirë. Vitin e ardhshëm na presin zgjedhjet. Për këtë qëllim kemi sjellë drejtime që do të ndihmojnë t'i zgjedhim kuadrot më kualitative pavarësisht përcaktimit të tyre intim për cilën opsion partiak janë përcaktuar. Është shumë me rëndësi që të zbatohen drejtimet për zgjedhje të drejta dhe demokratike, pa ndikime partiake dhe të kihet kujdes në terminet e propozuara. Pensionistët nuk janë apolitik, por sjellja jonë në mënyrë imperative duhet të jetë e tillë. Duhet të punojmë me të gjithë ata që janë relevant për ne pensionistët, për pensionet tona dhe përfitimet tjera, sepse është fakt se në këto kohëra të turbullta një prej shtyllave në familje jemi ne pensionistët.

(Kalina S. Andonova)

## Takimi i parë i veteranëve, mësuesve shqiptarë të Maqedonisë

Nën organizim të Shoqatës së pensionistëve nga Struga, më 7 mars të këtij viti u organizua Takimi i parë i veteranëve - mësuesve shqiptarë të Maqedonisë, i cili u mbajt në Strugë dhe Llabunishtë, me rastin e Ditës së Mësuesit shqiptar. "Në takimin e parë morën pjesë mësues shqiptar nga Shkupi, Çairi, Saraji, Kumanova, Tetova, Gostivari, Dibra, Kërçova, Manastiri, Ohri dhe Struga si nikoqire dhe organizatore," u shpreh sekretari i SHP Strugë, Izeir Mustafai dhe njëkohësisht sekretari i këshillit organizativ. Kryetari i këshillit organizativ të këtij takimi ishte Resul Bekteshi nga Struga. Sipas programit, mësuesit shqiptar vizituan SHFK "Braça Milladinovci" në Strugë, ndërsa pastaj karvani u nis drejt fshatit Llabunishtë të Strugës, ku në shkollën "Murat Llabunishtë" ju ishte organizuar një program kulturo-artistik. Takimi përfundoi me drekë të përbashkët në restorantin e hotelit "Joni" në fshatin Veleshtë të Strugës. Sponsor i të gjitha aktiviteteve ishte fabrika "ING LULI" nga Livadhia, pronësi e Gajur Logës. Në takim u vendos që ky të bëhet tradicional dhe të organizohet çdo vit në komanën të ndryshme. (S.K)

## Punë e frytshme dhe e suksesshme

Viti i kaluar 2017 punën e SHP Çair e ka karakterizuar arsyeshmëria dhe matura në shpenzimin e mejteve, ku është arritur masiviteti në aktivitete. Si barometër i politikave të tilla janë mjetet e kursyera të cilat janë dhënë për realizimin e aktiviteteve gjatë vitit aktual dhe pasqyron punën me përgjegjësi pa shkurtimin e aktiviteteve të planifikuara. Këto ishin theksimet kryesore të prezantuara në Kuvendin e SHP Çair që u mbajt më datë 5 mars 2018. Në mbledhje mori pjesë Metodija Novkovski, kryetari i LSHP të Qytetit të Shkupit. Ai shprehu fjalë miradije për punën e përgjegjshme dhe me kujdes të Shoqatës ku theksoi sukseset dhe përpjekjet e arritura të LSHP të Shkupit. Në mbledhje, me të cilën udhëhiqte Isen Zekiri, kryetari i Kuvendit të SHP Çair, janë shqyrtuar: llogaria përfundimtare për vitin 2017, Plani financiar për vitin 2018, Raporti i punës së Shoqatës për vitin 2017, Programi për punë për vitin 2018 dhe Raporti i Komisionit mbikëqyrës, të cilat u mira-



tuan njëzëri. Për detyrat programore, fjalën hyrëse e kishte Mentor Qoku, kryetari i SHP Çair. "Thuajse në të gjitha aktivitetet, gjatë vitit të kaluar, kemi arritur rezultate të theksuara. Disa aktiviteteve duhet t'u japim theks të veçantë, siç janë revytë folklorike, ndërsa sivjet jemi nikoqir të revysë rajonale të muzikës, këngëve dhe valleve, si dhe të garave sportive, aktivizim të grupit muzikor, organizim të ekskursioneve, ligjëratave me karakter edukativ e të

tjera. Këto aktivitete janë element i rëndësishëm për aktivizimin dhe bashkimin e pensionistëve", tha Mentor Qoku. Me diskutime konstruktive dhe propozime për rezultate më të mira në vitin 2018 morën pjesë: Mane Manev, Pero Milenkovski, Rauf Hamidi dhe të tjerë. Konkluzioni i mbledhjes ishte se rezultatet e arritura janë vepër e të gjithë pensionistëve anëtarë të Shoqatës.

(Vasil Paçemski)